



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

VOTIMI I SHTETASVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË JASHTË VENDIT

PËR
KOMISIONIN E REFORMËS ZGJEDHORE
NË KUVENDIN E SHQIPËRISË



PËRMBAJTJA

- HAPJE	1
I- QËLLIMI I REFORMËS SË VOTËS.....	2
II- ARGUMENTAT “KUNDRA” DHE “PRO”	6
III- KUADRI LIGJOR.....	9
IV- PJESËMARRJA NË PROCESET ELEKTORALE.....	11
- LLOJET E VOTIMIT.....	12
- PËRFAQËSIMI POLITIK	12
- REGJISTRIMI I VOTUESVE	14
- PROCEDURAT E VOTIMIT	16
V- KRAHASIM I SISTEMEVE TË VOTIMIT	18
- PJESËMARRJA.....	19
- LOGJISTIKA ZGJEDHORE.....	20
- SIGURIA E PROCESIT.	20
- AFATET KOHORE	21
- KOSTOT FINANCIARE	21
VI- ADMINISTRIMI I PROCESIT	22
- KONKLUZIONE	23

HAPJE

Qëllimi i këtij informacioni është një përmbledhje e vlerësimesh mbi mundësitë ligjore dhe administrative për të drejtën e votës shtetasve shqiptarë të cilët jetojnë jashtë vendit. Garantimi kushtetues, në parim, i të drejtës për të votuar për çdo shtetas që ka mbushur moshën 18 vjec ngre problemin e gjetjes së mënyrave të votimit për personat që ditën e votimit gjenden jashtë shtetit (për periudha afatshkurtra apo afatgjata). Sugjerimet e këtij dokumenti janë të hapura për diskutim dhe nuk përfaqësojnë qëndrime shterruese.

I- QËLLIMI I REFORMËS SË VOTËS





QËLLIMI I REFORMËS SË VOTËS

Garantimi i së drejtës së votës shtetasve shqiptarë jashtë atdheut paraqet disa vështirësi. Ato nuk janë të pakapërcyeshme dhe zbehen përballë argumenteve në favor të garantimit të së drejtës së votës.

Shqipëria nuk u ka mundësuar shtetasve të saj jashtë territorit të vendit të drejtën e votimit. Ky vlerësim bëhet kur janë rreth 115 shtete në botë dhe 41 në Europë, të cilat u lejojnë shtetasve të tyre të votojnë jashtë vendit. Pjesa më e madhe e këtyre vendeve, nuk ka një migracion kaq të madh në raport me popullsinë sa Shqipëria.

Nëse marrim parasysh numrin tepër të lartë të shtetasve shqiptarë jashtë atdheut vlerësohet se zgjedhjet shqiptare dhe rrjedhimisht institucionet që dalin prej tyre, janë me “legjitimitet” të cunguar. Gati gjysmës së votuesve, shtetas të Shqipërisë, aktualisht ju mohohet e drejta e votës.

E drejta e votës së lirë, të fshehtë dhe të barabartë është një nga të drejtat themelore dhe të patjetërsueshme të njeriut, e njohur si e tillë nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Kjo deklaratë nuk e përmend votimin jashtë vendit si një pjesë integrale të së drejtës së votës. Konventa të mëvonshme, si Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Migrantëve e vitit 1990, (e cila është nënshkruar dhe nga Shqipëria), u njeh migrantëve të drejtën e pjesëmarrjes në votime në shtetin e tyre të origjinës, ashtu siç parashikon detyrimin e shtetit të origjinës që t’u krijojë atyre mundësinë për të ushtruar të drejtën e votës.

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon dy kushte themelore për të drejtën e votës: atë të shtetësisë dhe atë të moshës 18 vjec në ditën e votimit (neni 45 i Kushtetutës). Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm për personat e paaftë mendërisht dhe nëse ka një vendim të gjykatës që i deklaron si të tillë.

Kur i referohet migrantëve jashtë vendit - afatgjatë apo afatshkurtër, Kushtetuta shprehet se: “Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet” (neni 8 i kushtetutës). Ajo shton se Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.

Mbrojtja e të drejta dhe gëzimi “de facto” i të drejtave kushtetuese nga migrantët, përfshirë dhe të drejtat politike, ndër to edhe e drejta e votës, kërkon marrjen e masave shtesë të organeve shtetërore, të cilat rregullohen me aktet ligjore dhe nënligjore specifike. Ligji për Emigrimin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi parashikon si qëllim të tij përkujdesjen, mbrojtjen, ruajtjen e identitetit kombëtar të shtetasve shqiptarë dhe forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës (neni 11 Ligjit për Emigrimin Shtetasve Shqiptarë Për motive Punësimi). Ai riafirmon të drejtën e përfaqësimit të emigrantëve nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të organizatave dhe shoqatave të tyre, të drejtën për të kontaktuar dhe bashkëpunuar me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore të shtetit shqiptar, si dhe me përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë në vendet pritëse, për të shprehur dhe mbrojtur interesat e tyre, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi (neni 7 i Ligjit Per Emigrimin...).

Kuri referohet të drejtës së organizimit dhe të drejtës së votës, Ligji për Emigrimin parashikon (neni 6) se:

1. Emigrantët shqiptarë gëzojnë të drejtat dhe liritë politike të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, si dhe të drejtën për të marrë pjesë aktive në jetën politike të vendit.
2. Autoritetet përgjegjëse krijojnë lehtësirat e nevojshme në mënyrë që emigrantët të ushtrojnë të drejtën e votës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pavarësisht se ligji i drejtohet vetëm një kategorie të migrantëve: atyre që janë larguar për qëllime punësimi, përcaktimi i detyrimit të shtetit për të lehtësuar procesin e votimit nga migrantët është me rëndësi. Lehtësitë për të votuar duhet t'u krijojnë jo vetëm migrantëve për motive punësimi por të gjithë migrantëve që janë larguar përkohësisht apo në mënyrë afatgjatë, për sa kohë kanë shtetësinë shqiptare.

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Kombëtar i Veprimit i Migracionit (2005-2010), parashikonin realizimin e një studimi fizibiliteti mbi mundësitë e votimit të emigrantëve në vendet pritëse dhe me pas, amendimin e Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Shërbimet Konsullore, në bazë të përfundimeve të studimit. Një studim i tillë nuk u ndërmor gjatë kohës që Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Kombëtar i Veprimit ishte në fuqi. Për pasojë, nuk është marrë ndonjë masë konkrete në zbatim të qëllimeve të Strategjisë Kombëtare për Migracionin (2005 - 2010).

Aktualisht, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë parashikon se:

“Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod. Çdo zgjedhës ka të drejtën e vetëm një vote për zgjedhjen e një subjekti zgjedhor”. (neni 3)

Kur specifikon kriteret për përfshirjen në listat e zgjedhësve, Kodi zgjedhor, në nenin 44, të ndryshuar me ligjin nr. 74/2012 parashikon këto kriteret:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të ketë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në datën e zgjedhjeve;
- c) të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar;
- ç) të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- d) të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit;

Pra, “vendbanimi” në territorin e një prej qendrave të votimit është një nga kriteret për regjistrimin në listat e zgjedhësve. Një pjesë e mirë e migrantëve kanë si vendbanim të përhershëm të regjistruar në vend, pranë një qendre votimi atë të banesës që posedojnë apo që kanë pasur, në varësi të gjendjes civile ku janë regjistruar, pavarësisht se vendbanimi i zakonshëm i tyre në migrim është një tjetër. Ata potencialisht kanë mundësi (ligjore) për të votuar por largësia nuk e bën atë të mundur.

Kodi Zgjedhor gjithashtu specifikon se zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 marsi deri më 30 qershor ose nga 15 shtatori deri më 30 nëntor (bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet e parashikuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 9 të këtij Kodi).

Qartazi vihet re se Kodi Zgjedhor ka përjashtuar çdo mundësi për proces të zhvilluar jashtë vendit, pasi specifikon “votimin në territorin e vendit”.

Ky specifikim i lë pa vlerë, në praktikë, dispozitat e “Ligjit për Emigrimin...”, i cili përcakton detyrimin e autoriteteve përgjegjëse për të krijuar lehtësitë për votimin e migrantëve.

Vlerësohet se baza ligjore për të drejtën e votës në Shqipëri është jo koherente.

- Kushtetuta përcakton një të drejtë universale, pa vendosur kufizim territori.
- Ligji për Emigrimin, që në përputhje me dispozitën kushtetuese, kërkon garantimin praktik të së drejtës së votës për një kategori shtetasish, që për shkak të dinamikës së përgjithshme të zhvillimit të shoqërisë shqiptare gjenden jashtë territorit.
- Kodi Zgjedhor, i cili përcakton në mënyrë të detajuar kriteret për t’u përfshirë në trupin elektorale - duke shtuar edhe vendbanimin krahas moshës dhe shtetësisë.
- Përfshirja e këtij kriteri të vendbanimit përjashton shtetasit që gjenden jashtë vendit ditën e votimit dhe përbën një kufizim të së drejtës kushtetuese të votës. Aktualisht, nuk është vlerësuar dhe as nuk është dhënë ndonjë justifikim për kufizimin e kësaj të drejte.

Kuvendi duhet të vlerësojë faktin që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon të drejtën e çdo shtetasi që të zgjedhë dhe të zgjidhet. Ky parim universal nuk ka gjetur konkretizimin e vet në Kodin Zgjedhor të vendit i cili praktikisht nuk u krijon mundësinë shtetasve shqiptarë që banojnë në një shtet tjetër të votojnë për zgjedhjet e përgjithshme legjislative apo në referendumet kombëtare në Shqipëri.

KUNDRA

PRO

**II- ARGUMENTET
“KUNDRA” DHE “PRO”**



ARGUMENTET “KUNDRA” DHE “PRO”

Votimi jashtë shtetit është ende një çështje e diskutueshme në nivel ndërkombëtar. Ai është kompleks për shkak të problematikës lidhur me mënyrën e realizimit në praktikë. Argumentat janë pro dhe kundër krijimit të mundësive për të votuar jashtë vendit. Disa prej argumentave janë artikuluar nga GJEDNJ në jurisprudencën e saj dhe janë artikuluar nga Komisioni i Venecias si më poshtë:

1. Argumenta për kufizimin e të drejtës për të votuar vetëm për personat që janë rezidentë në territorin kombëtar:

- Mendohet se jo rezidentët janë më pak të lidhur dhe më pak të interesuar apo kanë më pak informacion për problemet ditore të shtetit;
- Vështirësitë e realizimit në praktikë të shpалosjes së kandidaturave parlamentare për personat që jetojnë jashtë;
- Influenca e shtetasve që janë rezidentë në zgjedhjen e kandidatëve dhe formulimin e programeve të tyre;
- Duhet të ekzistojë një raport midis të drejtës për të votuar në zgjedhjet parlamentare dhe ndikimit efektiv nga trupat politike të zgjedhur.

2. Argumenta në favor të votimit jashtë vendit të migrantëve:

- E drejta për të votuar është një e drejtë që ekziston për shkak të shtetësisë jep ndjesinë e shtetësisë dhe të drejtave të lidhura me të.
- Vazhdimësia e pjesëmarrjes në jetën politike të vendit, pavarësisht largësisë.
- Barazon ata që jetojnë në vend me ata që janë jashtë - pra vendos në pozitë të njëjtë shtetasit.
- Shtetasi mban lidhje me vendin e origjinës, forcon lidhjen dhe ndjesinë e përkatësisë, pavarësisht gjendjes ekonomike, etj.

Personat që gjenden afatshkurtër, për udhëtim, personal apo bizenisi, ata që janë për studime apo punë për një periudhë të shkurtër apo të përcaktuar dhe ata që janë afatgjatë në varësi të kategorisë, shtete të ndryshme kanë rregullim të ndryshëm. Rregullimi varet edhe nga lloji i zgjedhjeve - të përgjithshme dhe lokale. Shtetet që lejojnë votimin jashtë vendit, parimisht e lejojnë këtë për shtetasit me qëndrim afatshkurtër dhe për zgjedhjet e përgjithshme. Varion në situata të ndryshme ligjore kur bëhet fjalë për rezidentët afatgjatë dhe zgjedhjet lokale. Shtetet që njohin votimin jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare janë Algjeria, Bjellorusia, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Gjerogjia, Gjermania, Hungaria, Italia, Koreja, Kirgistani, Letonia, Lihtenshtejni, Lituania, Luksemburgu, Moldavia, Monako, Holanda, Peruja, Polonia, Portugalia, Rumania, Rusia, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Maqedonia, Ukrahina dhe UK, por jo të gjithë këto vende njohin votimin jashtë për zgjedhjet lokale. Vetëm Zvicra, Suedia, Spanja, Monako, Lituania, Lihtenshtejni, Finlanda, Bjellorusia dhe Algjeria e njohin votimin jashtë vendit edhe për zgjedhjet lokale. Në kuadër të Këshillit të Evropës, vetëm Shqipëria, Andorra, Qipro dhe Malta nuk njohin të drejtën për të votuar jashtë të shtetasve të tyre (Andorra njih votimin paraprak, për shtetasit që do lëvizin afatshkurtër, kurse Malta rimbursen rreth 90% të kostove të udhëtimit)

Diferenca ka lidhur edhe me kohën e qëndrimit jashtë vendit psh: në Danimarkë mund të votojnë jashtë vendit vetëm ata që janë përkohësisht, por që zakonisht jetojnë në Danimarkë. Në Gjermani, ata që janë me qëndrim afatgjatë mund të votojnë vetëm për zgjedhjet e përgjithshme, (por nuk duhet të kalojnë më shumë se 25 vjet jashtë Gjermanisë).

Disa nga vendet e kanë të përcaktuar në Kushtetutë të drejtën për të votuar jashtë shtetit të shtetasve jo-rezidentë, kurse të tjerë e kanë të përcaktuar në ligje specifike (Italia, Franca, Portugalia dhe Zvicra e njohin të drejtën për të votuar të shtetasve jashtë, në Kushtetutë. Greqia ka përcaktuar në Kushtetutën e saj detyrimin e legjislativit për të miratuar me ligj modalitetet e votimit jashtë vendit). Në shtetet të tjera, çështja është rregulluar me ligje specifike.

Neni 3 i Protokollit 1 të KEDNJ parashikon se shtetet palë organizojnë zgjedhje të lira në intervale kohe të arsyeshme, me votim të fshehtë, në kushte që mundësojnë shprehjen e lirë të mendimit të njerëzive në zgjedhjet legjislative. Protokollin nuk parashikon asgjë lidhur me të drejtën për të votuar jashtë.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka inkurajuar shtetet që të lejojnë shtetasit e tyre që jetojnë jashtë të marrin pjesë në mënyrë sa më të plotë të jetë e mundur në procesin elektoral. Kjo është parashikuar në dy dokumente: Rezoluta e vitit 1459 (2005) dhe Rekomandimi nr. 1714 (2005) për të drejtën e votës.

Në Kodin e Praktikave të Mira mbi Çështjet Elektorale të Komisionit të Venecias parashikohet se: E drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur mund tu akordohet shtetasve që jetojnë jashtë vendit... Por, kur iu referua çështjes së Armenisë, që synonte heqjen e të drejtës për të votuar jashtë vendit të Armenëve, Komisioni i Venecias u shpreh se: "Shtetet, duke marrë në konsideratë rregullimet lidhur me votimin jashtë duhet të balancojnë të drejtën e votimit universal përkundër transparencës dhe sigurisë gjatë zgjedhjeve. Kjo është edhe çështje e kostove lidhur me nivelin deri ku mund të akomodohet numri i personave që votojnë jashtë. Një reformë që efektivisht heq të drejtën për të votuar të disa qytetarëve (në këtë rast të qytetarëve jashtë) duhet të justifikohet me kujdes".

Një çështje e rëndësishme që do të sillte ndryshime lidhur me qasjen në nivelin e KE-së dhe GJEDNJ është "çështja Sitaropoulos dhe Giokoumopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë". Në këtë çështje, zyrtarë Grekë të punësuar në strukturat e Komisionit Evropian ngritën padi kundër Greqisë për mosmarrjen e masave për të lejuar efektivisht ushtrimin e të drejtës së votës nga shtetasit grekë me rezidencë jashtë vendit. Në Kushtetutën e saj të vitit 1975, në nenin 51 Kushtetuta Greke parashikon autorizimin për legjislatorin që të miratojë kushtet ligjore që shtetasit jashtë të ushtrojnë të drejtën e votës jashtë vendit. Për 35 vjet nuk u mor asnjë masë për të vënë në vend këtë objektiv. Ndaj GJEDNJ i dha të drejtë aplikuesve se e drejta e tyre për të votuar jashtë shtetit territorial, e parashikuar nga Kushtetuta ishte shkelur.

GJEDNJ u shpreh se në momentin që ka një bazë ligjore/kushtetuese, kjo krijon pritshmëri për individët se kanë një të drejtë... për pasojë, e drejta duhet të mundësohet efektivisht. Rasti i Shqipërisë është i ngjashëm me atë të Greqisë. Pavarësisht se nuk është përcaktim kushtetues, Ligji për Emigrimin e Shtetasve Shqiptarë për Motive punësimi krijon pritshmëri për migrantët lidhur me lehtësira potenciale për votimin jashtë vendit. Analiza e përvojave të vendeve të tjera lidhur me të drejtën e votimit jashtë vendit reflekton tendencën e lejimit të votimit jashtë vendit.

The image features a stylized blue silhouette of a balance scale on the left side. The scale's pan is positioned in the center of the frame. The background is a light blue gradient with faint, semi-transparent circular patterns that resemble gears or technical diagrams. In the bottom left corner, there is a stack of books and papers, with a pen resting on top. The overall aesthetic is professional and legal. The text 'III- KUADRI LIGJOR' is centered within the scale's pan.

III- KUADRI LIGJOR



III

KUADRI LIGJOR

Garantimi i së drejtës kushtetuese për të votuar jashtë vendit do të kërkojë krijimin e kuadrit të duhur ligjor. Kjo do të kërkojë që Kodi Elektoral i Shqipërisë të marrë parasysh pikat e mëposhtme:

- modelin e përfaqësimit politik për votën jashtë vendit;
- procedurat e votimit;
- krijimin e listave për votuesit e jashtë vendit;
- ngritjen e strukturave që do të administrojnë procesin;
- buxhetin për të mbuluar kostot e votimit jashtë vendit.



***IV- PJEËMARRJA
NË PROCESET ELEKTORALE***



IV

PJESËMARRJA NË PROCESET ELEKTORALE

- LLOJET E VOTIMIT

Garantimi i votës jashtë vendit nënkupton zbatimin e masave dhe procedurave që u mundësojnë të gjithë zgjedhësve që gjenden jashtë vendit përkohësisht ose në mënyrë permanente dhe që kanë shtetësinë shqiptare.

Çështja se në cilat zgjedhjeve duhet lejuar votimi jashtë vendit është një çështje e rëndësishme pasi përcakton se cilat institucione apo nivele të qeverisjes do të ndikohen nga votuesit jashtë vendit.

Kushtetuta e Shqipërisë përcakton tre lloj votimesh në:

- zgjedhjet e përgjithshme legjislative
- zgjedhjet lokale
- referendumet

Një opsion i reformës zgjedhore është që votuesve jashtë vendit t'u mundësohet pjesëmarrja në:

- zgjedhjet e përgjithshme legjislative
- referendumet kombëtare

Ky model pjesëmarrjeje vlerëson se zgjedhjet lokale prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë shtetasit shqiptarë që jetojnë brenda territorit të Shqipërisë dhe brenda njësisë administrative, duke pasur një ndikim jo të madh tek interesat e shtetasve të cilët jetojnë jashtë vendit. Ky vlerësim e prek parimin kushtetues e të drejtës së votës në zgjedhje. Ai vlerëson votimet, të cilat kanë ndikim në zhvillimet kombëtare shqiptare duke përcaktuar votën e shtetasve jashtë vendit për përfaqësimin legjislativ dhe për çështje të cilat janë me interes kombëtar.

- PËRFAQËSIMI POLITIK

Çështja e përfaqësimit të votuesve jashtë vendit në rastin e referendumeve kombëtare mund të konsiderohet më e lehtë, pasi votimi kryhet në rang kombëtar dhe nuk ka ndarje në qarqe elektorale. Votimet përzgjedhjet e përgjithshme legjislative nga ana tjetër paraqesin më tepër vështirësi. Për përfaqësimin politik të votuesve jashtë vendit ekzistojnë disa modele të ndryshëm të cilët pasqyrojnë sistemet elektorale të vendeve përkatëse. Zbatimi i një modeli të caktuar përfaqësimi përcakton edhe influencën që do të kenë votuesit jashtë vendit në proceset elektorale.

Sistemi elektoral i një vendi përbën faktorin kryesor në përzgjedhjen e modelit të përfaqësimit vendimin për t'u dhënë shtetasve që banojnë jashtë territorit të vendit mundësinë për të votuar.

Proporcionali kombëtar është modeli më i lehtë për të aplikuar votën jashtë vendit pasi të gjithë votuesit, në këtë rast, janë të regjistruar në një qark elektoral të vetëm.

Ekzistojnë tre modele të ndryshme të përfaqësimit politik të votuesve jashtë vendit, të cilët diskutojnë vështirësitë që mbart në vetvete sistemi proporcional rajonal.

Në Shqipëri territori i vendit ndahet në 12 qarqe elektorale. Për regjistrimin dhe votimin e votuesve jashtë vendit paraqiten këto probleme sipas varianteve të mëposhtme të përfaqësimit politik:

1- Përfaqësimi i migracionit në një qark elektorale "ekstraterritorial"

Ky model është ai sipas të cilit votuesve të jashtëm u caktohet një (apo disa) qarqe elektorale "ekstraterritorial". Një model i tillë përdoret nga pak vende, ku migracionit i njihet e drejta të zgjedhë anëtarë të parlamentit në një qark të jashtëm electoral (në rastin e Kroacisë numri i anëtarëve të parlamentit që dalin nga ky qark ndryshon dhe vendoset në bazë të një formule, e cila pjeston numrin e përgjithshëm të votave jashtë vendit me mesataren e votave për anëtar parlamentit brenda territorit të vendit), pra ky sistem merr parasysh pjesëmarrjen në zgjedhje të shtetasve jashtë vendit duke u munduar të mos shtrembërojë përfaqësimin demokratik në jetën politike të vendit.

Ky model funksionoi mirë në rastin e Kroacisë. Ai përbën një mënyrë për të zgjidhur vështirësitë që paraqet votimi për një vend që ka sistem elektorale proporcional rajonal. Për Shqipërinë, ekzistojnë disa vështirësi për një sistem i tillë zgjedhor.

- Së pari, ky model do të kërkonte ndryshime thelbësore në kushtetutë, pasi kushtetuta shqiptare nuk lejon qarqe elektorale ekstraterritoriale,
- Së dyti, nëse merret parasysh numri tejet i madh i votuesve potencialë jashtë vendit në rastin e Shqipërisë, për të pasur një përfaqësim demokratik të drejtë do të duhej që nga një qark ekstraterritorial hipotetik të zgjidheshin afërsisht gjysma e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë. Natyrisht, një propozim i tillë do të haste në kundërshtime të forta politike.
- Arsyeja e tretë lidhet me një aspekt tjetër të përfaqësimit politik. Kjo nis nga fakti që shpërndarja e madhe gjeografike e shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë vendit dhe interesi i këtyre komuniteteve në zgjedhjet në Shqipëri nuk lidhet me ndonjë "qark abstrakt ekstraterritorial" se sa me fatin e familjeve të tyre të cilat jetojnë brenda territorit shqiptar.

2- Përfaqësimi migracionit në një nga qarqet elektorale brenda vendit

Një praktikë e tillë ndiqet nga disa vende, ndër të cilat Polonia dhe Letonia. Në këtë rast, të gjithë votuesit jashtë vendit vendosen në listat e votimit në një nga qarqet elektorale ekzistuese brenda territorit të vendit, kryesisht në kryeqytet. Një zgjidhje e tillë e lehtëson aspektin administrativ të procesit pasi të gjithë shtetasit jashtë vendit votojnë në një qark elektorale. Votat e tyre mbledhen nga strukturat shtetërore të ngarkuara me ligj dhe transferohen menjëherë në qarkun elektorale përkatës.

Në aspektin politik, ky model u jep një "peshë" të padrejtë votuesve të jashtëm në sistemin elektorale. Ai është i kritikueshëm pasi mund të shërbejë për të ndryshuar rezultatin në një qark të caktuar. Kjo mund të vërë në pyetje edhe vetë legjitimitetin e votimit jashtë vendit. Për shembull, nëse shtetasit jashtë vendit votojnë në kryeqytet, ekziston mundësia që humbësit të kontestojnë rezultatet dhe që qytetarët e kryeqytetit të perceptojnë se vota jashtë vendit po u mohon atyre mundësinë të ndikojnë në fatet e rajonit të tyre.

3- Përfaqësimi migracionit sipas qarqeve elektorale ekzistuese në vend

Në këtë model shtetasit jashtë vendit votojnë në qarqet elektorale të qendrave të tyre të banimit përpara largimit të tyre nga vendit apo ku ata janë regjistruar. Ai nuk shtrembëron përfaqësimin demokratik, duke u dhënë kështu votuesve jashtë vendit peshën e tyre reale në jetën e vendit. Duke pasur parasysh përmasat e komunitetit shqiptar jashtë vendit, ky model shmang një përqëndrim rajonal të njëanshëm të votuesve të caktuar në mënyrë arbitrare. Në këtë rast, interesat e votuesve jashtë vendit lidhen me interesat e familjeve të tyre në Shqipëri dhe u lejon atyre të kenë një ndikim më të drejtpërdrejtë në përcaktimin e fatit të vendit në tërësi, por dhe të vendlindjes së tyre në veçanti. Ky model nuk shkakton shtrembërime të përfaqësimit demokratik.

- REGJISTRIMI I VOTUESVE

Eksperiencat e shumë vendeve kanë treguar se sa më të vështira e të ndërlikuara të jenë procedurat e regjistrimit për votuesit jashtë vendit, aq më e ulët është pjesëmarrja e tyre në votime. Për të garantuar mundësinë e votimit një numri sa më të madh shtetasish jashtë vendit do të duhet që procedurat e regjistrimit të jenë sa më të thjeshta, pa anashkaluar kriteret që nevojiten për sigurinë e procesit.

Shteti shqiptar nuk disponon ende të dhëna të sakta për shtetasit e tij jashtë atdheut dhe vendbanimet e tyre. Në këtë proces është e nevojshme që këta shtetas të shprehin vetë dëshirën e tyre për të votuar:

1. duke bërë një kërkesë për këtë qëllim me anë të postës
2. nëpërmjet postës elektronike duke ju drejtuar një strukturë të posaçme të krijuar pranë institucionit përgjegjës (pranë KQZ-së), i cili do të merret me procesin e regjistrimit të votuesve.
3. duke u paraqitur në misionet diplomatike të Shqipërisë

Kërkesës për t'u regjistruar duhet t'i bashkëngjitet adresa postare dhe mundësisht një adresë emaili. Në këtë mënyrë strukturat përgjegjëse të shtetit shqiptar do të kenë një vlerësim të saktë për numrin e shtetasve jashtë vendit që duan të marrin pjesë në votim. Shtetasit jashtë vendit që kanë shprehur interesin që të marrin pjesë në votim, u nisët me postë rekomande dhe kthim, të parapaguar nga shteti shqiptar, apo me postë elektronike, një material informativ ku shpjegohen procedurat e regjistrimit si dhe një formular regjistrimi. Formulari do të përmbajë pyetje mbi të dhënat personale të shtetasve, numrin e pasaportës si edhe informacion mbi njësinë administrative në Shqipëri ku ata janë (ose kanë qenë) të regjistruar përpara largimit nga vendi. Shtetasve jashtë vendit do t'u kërkohet po ashtu, të tregojnë nëse dëshirojnë që hapat e mëtejshme të regjistrimit t'i kryejnë me shërbim postar ose me postë elektronike. Procedura e regjistrimit të tyre do të vendoset në bazë të kësaj zgjedhjeje.

Në të njëjtën kohë shtetasve jashtë vendit do t'u kërkohet të nënshkruajnë dhe një deklaratë ku të shprehin pëlqimin që emrat e tyre të spastrohen nga listat e votuesve brenda vendit duke i vendosur në një listë të posaçme për votuesit jashtë vendit.

- Rregjistrimi me shërbim postar (rekomande) i dërgon materialet shtetasve jashtë

vendit të parapaguara nga shteti shqiptar. Një nga rregullat e postes rekomande është që materiali nuk dorëzohet po qe se marrësi - i cili duhet detyrimisht të jetë personi të cilit i është adresuar dërgesa – nuk paraqet një dokument të vlefshëm identifikimi si pasaporta apo karta e rezidencës. Në rastin konkret kjo praktikë shërben për të konfirmuar identitetin e shtetasit që ka shprehur interesin për t'u bërë “votues i jashtëm”, duke shmangur në këtë mënyrë abuzime të mundshme. Pasi shërbimi postar raporton listën e personave që kanë marrë në dorëzim materialin që shërben për regjistrimin e tyre si votues të jashtëm dhe dorëzon formularët e plotësuar të aplikimit te struktura përkatëse që cakton ligji zgjedhor, ajo bën verifikimin e aplikimeve dhe të identitetit të shtetasve sipas të dhënave që disponon shteti shqiptar.

Emrat e shtetasve që kane paraqitur kërkesën për të votuar, përfshihen në listën e “votuesve të jashtëm”. Ata ndahen sipas qarqeve elektorale në të cilat ku ju figuron emri në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, emrat e tyre largohen nga listat e votuesve që votojnë brenda territorit të Shqipërisë për të shmangur mbivendosjet.

Shtetasve me banim jashtë shtetit ju dërgohet një kod individual regjistrimi në formën e një bar-kodi të skanueshëm i cili do të shërbejë si element kryesor identifikues, ku përveç të dhënave personale të “votuesit të jashtëm” do të përfshihet dhe informacioni për qarkun ku vota e tij do të llogaritet. Informacioni që përmban bar-kodi do të jetë i shifruar dhe do t'i referohet informacionit të bazës së të dhënave qendrore për votuesit jashtë vendit të krijuar nga struktura e caktuar për të administruar votën e shtetasve shqiptarë jashtë atdheut.

Dërgimi i kodit individual të regjistrimit do të kryhet me anë të postës rekomande dhe duhet të përfundojë 60 ditë përpara zhvillimit të zgjedhjeve. Kjo edhe për t'u dhënë mundësi ankimimi shtetasve jashtë atdheut të cilët ende nuk kanë marrë kodin individual të regjistrimit. Ky proces duhet të fillojë të paktën 6 muaj përpara ditës së zgjedhjeve dhe duhet të përfundojë të paktën 60 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

- Mënyra tjetër e regjistrimit është ajo përmes rrjetit të internetit. Ky regjistrim kryhet në një faqe zyrtare të krijuar posaçërisht për këtë qëllim. Shtetasit të cilët marrin konfirmimin nga autoritetet shqiptare që kërkesa e tyre për të votuar është regjistruar, si dhe informacionin për procedurën e regjistrimit, kanë mundësi të aplikojnë online duke plotësuar formularin e regjistrimit. Këta shtetas duhet po ashtu të deklarojnë se dëshirojnë të përfshihen në listën e “votuesve të jashtëm”. Pasi të kenë futur në sistem të dhënat e tyre personale, si emër, mbiemër, datëlindje, numër pasaporte, adresën në shtetin pritës si dhe vendbanimin që kanë pasur në Shqipëri përpara se të largoheshin jashtë shtetit, struktura përkatëse kryejnë verifikimin e këtyre të dhënave. Brenda një periudhe 1 deri 2 javore sistemi gjeneron kodin individual të regjistrimit, të skanueshëm, të cilin këta shtetas do të kenë mundësi ta printojnë vetëm një herë.

- Votuesit regjistrimin jashtë vendit në listat e zgjedhësve mund ta bëjnë në konsullata/ambasada. Mund të jetë i regjistruar si migrant - pra personi që është jashtë në zyrat e gjendjes civile (psh. rasti i Hollandës), kurse në Zvicër vlerësohen të dhënat e atyre që janë jashtë bazuar në informacionin që ka zyra e taksave. Regjistrimi mund të behet brenda 180 ditëve apo edhe para 3 ditëve nga dita e votimit, në varësi të shteteve. Forma e aplikimit për regjistrim për votim mund të jetë me shkrim, apo deklaratë verbale. Në pjesën më të madhe aplikimi cohet në konsullatë/ambasadë, në zyrat lokale si edhe në autoritetet kombëtare.

- PROCEDURAT E VOTIMIT

Për mundësimin e votimit jashtë vendit mundësohen dy procedura votimi:

- 1) *VOTIMI I DREJTPËRDREJTË NË QËNDRA TË POSAÇME VOTIMI,*
- 2) *VOTIMI ME POSTË.*

VOTIMI I DREJTPËRDREJTË

Votimi i drejtpërdrejtë në qendra të posaçme votimi do të kryhej njëloj siç bëhet aktualisht votimi brenda territorit të Shqipërisë. Votuesit jashtë vendit do të paraqiten në qendrën e votimit të ngritur posaçërisht për këtë qëllim, të pajisur me pasaportë dhe me kodin individual të regjistrimit, duke votuar për qarkun elektorale në të cilin janë regjistruar.

VOTIMI ME POSTË

Me këtë mënyrë votimi shtetasit e regjistruar si votues të jashtëm, do të kenë dy mundësi për të marrë fletët e votimit:

- duke i shkarkuar nga faqja zyrtare në internet,
- duke i marrë me anë të postës.

Procesi i dërgimit të votës për në Shqipëri detyrimisht do të kryhet nëpërmjet postës speciale.

Ata shtetas të cilët nuk do kenë mundësi akses në internet, mund t'i marrin fletët e votimit nëpërmjet një shërbimi postar special të paguar nga shteti shqiptar. Që të mund të marrin fletën e votimit, atyre do t'u duhet të paraqesin kodin e tyre individual të regjistrimit, pasaportën, si dhe të firmosin mandatin e postës. Ky proces është vështirësisht i manipulueshëm sepse për të marrë kodin individual të regjistrimit çdo votues i jashtëm do të duhet t'u nënshtrohet disa masave sigurie.

Votuesit që kanë akses në internet kanë mundësi ta printojnë fletën e votimit nga faqja zyrtare duke futur për këtë qëllim të dhënat e tyre personale si dhe kodin e regjistrimit. Çdo votues do të mund të printojë vetëm një fletë votimi. Ata që zgjedhin këtë metodë nuk do t'u dërgohet fletë votimi me anë të postës. Nga kjo faqe zyrtare ata mund të shkarkojnë edhe informacionin mbi partitë politike dhe kandidatët e tyre në qarqet elektorale përkatëse. Të gjithë ata shtetas që do të dëshirojnë të bëhen "votues të jashtëm" do të duhet të tregojnë qartë se cilën nga këto dy alternativa preferojnë. Zgjedhja e njëre alternative nënkupton automatikisht përjashtimin nga tjetra.

Çdo "votues i jashtëm" e vendos fletën e tij të votimit në një zarf të pashënuar, të cilin më pas, së bashku me një fotokopje të pasaportës dhe kodin individual të regjistrimit (pra bar-kodin e printuar apo të marrë me postë), e fut në një zarf të dytë, i cili do t'u jepet nga shërbimi postar. Një mënyrë tjetër është që "zarfi i dytë" t'i jepet votuesve jashtë vendit nga shërbimi postar i pajisur paraprakisht me kodin individual të identifikimit. Edhe në këtë rast "votuesit të jashtëm" do t'i

duhet të paraqesë një dokument të vlefshëm identifikimi tek kompania postare e cila është ngarkuar me administrimin e këtij procesi (duke dërguar njëkohësisht edhe një kopje të pasaportës së tij).

Pas mbërritjes në Shqipëri të zarfeve, struktura përgjegjëse për administrimin e votës bën verifikimin e të dhënave të çdo shtetasi, pra skanon bar-kodin apo fut të dhënat në kompjuter, për të përcaktuar qarkun për të cilin është votuar. Vetëm pas kësaj, zarfet e pashënuar që përmbajnë votat e votuesve të jashtëm, shpërndahen sipas qarqeve elektorale përkatës, duke siguruar në këtë mënyrë fshehtësinë e votës së secilit votues.

V- KRAHASIMI I SISTEMEVE TË VOTIMIT





KRAHASIMI I SISTEMEVE TË VOTIMIT

- PJESEMARRJA

Vështirësia kryesore që has çdo model për votimin e shtetasve jashtë vendit është ajo e përfaqësimit, pra e krijimit të një sistemi i cili i lejon një numri sa më të madh votuesish pjesëmarrjen në votime. Në këtë aspekt votimi me postë ka avantazhe ndaj votimit të drejtpërdrejtë.

Votimi i drejtpërdrejtë në qendra votimi, qofshin këto në misionet diplomatike shqiptare apo në qendra të posaçme votimi do të përjashtojë nga votimi një numër të konsiderueshëm votuesish potencialë. Votimi pranë misioneve diplomatike do të ishte i pamundur nëse merret parasysh numri i madh i shtetasve shqiptarë që aktualisht banojnë për shembull në Greqi apo Itali. Shumë shtetas në këto kushte do të preferonin të mos merrnin pjesë në votime për arsye kohore apo financiare. Ky arsyetim vlen edhe në rast se shteti shqiptar do të hapë qendra të posaçme votimi. Këto qendra votimi, vështirë se do të kishin një shtrirje aq kapilare sa të mundësonin votën e atyre shqiptarëve që jetojnë në një ishull të largët të Greqisë apo në një qytezë në Kanada apo të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për më tepër, këtij arsyetimi i shtohet edhe fakti që ka vende ku Shqipëria nuk ka misione diplomatike apo precedentë të vendeve pritëse të migracionit, si Zvicra, e cila nuk u lejon shtetasve të huaj votimin e drejtpërdrejtë në territorin e vendit.

Votimi me postë, nga ana tjetër, nuk has në probleme të tilla. Ai mund t'i garantojë votimin çdo shtetasi shqiptar kudo që ai ose ajo të ndodhet. Kjo procedurë votimi garanton një pjesëmarrje më të madhe.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës njohin të drejtën për të votuar jashtë të shtetasve të tyre që ditën e zgjedhjeve nuk janë në vend. Ata mund të votojnë elektronikisht me email ose duke e shkarkuar nga interneti fletën e votimit dhe më pas duke e nisur atë me postë, ose me faks. Për këtë qëllim, shtetasi aplikon paraprakisht dhe jep adresën online, numrin e faksit ose adresën e banesës. Marrja e fletës së votimit ndodh rreth 45 ditë përpara dites së votimit. Fushtata të tëra informimi dhe faqe informative në internet parashtrajnë me detaje mënyrat e votimit. Për çdo vështirësi shtetasi Amerikan konsulton me ambasadën më të afërt të shtetit ku është. Mënyrat e dërgimit të fletës së votimit nga votuesit janë: me postë ndërkombëtare, në ambasadë, konsullatë e cila më pas e nis në SHBA. Zarfë duhet të përfshijë edhe koston e dërgesës. Forma të tjera të nisjes së fletës së votimit janë me korier.

Një procedure specifike ndiqet nëse fleta e votimit nuk është marrë deri në ditën e 30 të votimit. Pa u ndalur më gjatë në specifikat e këtij procesi, duhet vlerësuar se secila nga këto forma mund të kishte qenë e përshtatshme edhe për migrantët shqiptarë jashtë vendit, pasi përfshin një sërë mënyrash - formë elektronike, faks, postë të thjeshtë ndërkombëtare, korier dhe Ambasadë. Këto mënyra përdoren edhe në vende të tjera. Studimi i kryer nga Komisioni i Venecias, gjeti se votimi me anë të postës për shtetasit realizohet jashtë vendit për shtete si: Austria, Gjermania, Irlanda, Italia, Lihtenshtejni, Luksmburgu, Meksika, Sllovakia etj. Vende të tjera njohin votimin jashtë vendit në Ambasada apo konsullata në prezencën e vetë personit. Të tilla janë Brazili, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Gjergjia, Moldavia, Mali i Zi, Maroku, Polonia, Rumania, Rusia, Serbia, Ukraina etj. Këtë metodë e përdorin edhe vende si Algjeria, Bjellorusia, Norvegjia, Belgjika, Bosnja Hercegovina, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Lituania, Letonia etj. Votimi elektronik është duke u përdorur në Estoni, Hollandë dhe Zvicër. Kurse disa vende

si Bjellorusia, Danimarka, Andorra, Finlanda, Lituania, Kirgistani etj., njohin votimin paraprak, për personat që largohen për periudha afatshkurtra, që variojnë nga disa ditë në 3 muaj. Në Mbretërinë e Bashkuar, Algjeri, Belgjike, Francë, Monako, Hollandë, Suedin jhetedhe votime prokurë.

Raporti i Komisionit të Venecias lidhur me Votimin Jashtë Vendlit parashikon udhëzime dhe rekomandime mbi mënyrat që mund të ndiqen për të mundësuar ushtrimin në fakt të së drejtës së votës nga emigrantët jashtë vendlit.

- LOGJISTIKA ZGJEDHORE

Në procesin e votimit të shtetasve jashtë vendlit do të shfaqen vështirësi të cilat lidhen me logjistikën.

Në votimin e drejtpërdrejtë hapja e qendrave të votimit në të gjitha vendet ku jetojnë e banojnë shqiptarë do të kthehej në një "makth" logjistik. Edhe nëse hamendësohet se kjo do të arrihej të bëhej, ajo do të zgjidhte problemin e votimit në referendume kombëtare, por jo atë të votimit në zgjedhje të përgjithshme legjislative. Sistemi aktual elektoral me 12 qarqe elektorale do të kërkonte në çdo qendër votimi jashtë vendlit të kishte 12 kuti votimi dhe një numër të saktë fletësh votimi në përputhje me qarqet elektorale ku janë regjistruar votuesit e jashtë vendlit. Transporti i këtyre materialeve drejt qendrave të votimit dhe pastaj anasjelltas drejt Shqipërisë do të ishte një mision i vështirë. Nga ana logjistike, votimi i drejtpërdrejtë është i papërshtatshëm për një sistem elektoral proporcional rajonal (Indonezia zbatoi një model të tillë deri në një moment kur ndarja e vendlit në një numër distriktesh elektorale e bëri procesin të pamënaxhueshëm).

Votimi me postë nuk has në vështirësi të tilla. Ai i adreson të gjitha problemet logjistike që mbart sistemi proporcional rajonal. Një shërbim postar special mund të shpërndajë dhe mbledhë fletët e votimit në një mënyrë mjaft më të shpejtë e efikase se çdo të ndodhte nëse një proces i tillë merret përsipër nga shteti shqiptar.

- SIGURIA E PROCESIT

Në teori, duket sikur votimi i drejtpërdrejtë garanton transparencë dhe siguri më të madhe për procesin e votimit. Në se shqyrtohet me kujdes edhe në këtë aspekt votimi me postë gëzon një numër avantazhesh karshi votimit të drejtpërdrejtë. Votimi i drejtpërdrejtë, do të trajtohej domosdoshmërisht nga përfaqësitë diplomatike shqiptare. Ato edhe pse në teori janë të pavarura dhe jo-politike, në realitet janë vlerësuar nga palët politike si të mbushura me "lidhje" të partive në pushtet. Ky vlerësim do të përfshinte interesat e politikës në administrimin e procesit dhe do të favorizonte partinë në pushtet. Edhe nëse misionet diplomatike janë jopolitike, do të mjaftonte perceptimi i tyre si të tilla për t'u dhënë argumente atyre që duan të kontestojnë rezultatet e votimit. Votimi me postë, nga ana tjetër duke e pasur shpërndarjen dhe mbledhjen e fletëve të votimit në një shërbimi special postar, e shmang përfshirjen e interesave të politikës në proces.

Votimi i drejtpërdrejtë ka probleme të tjera lidhur me sigurinë. Ai lë të hapur çështjen se si do të siguroheshin materialet zgjedhore dhe kutitë e votimit gjatë transportit apo pas përfundimit të

votimit. Sigurimi i transportit apo numërimit në ato dhjetëra apo dhe qindra qendra votimi të cilat do të nevojiteshin për votimin e drejtpërdrejtë lë të hapur mungesën e garancive. Votimi me postë nga ana tjetër i trajton më mirë problemet duke e lënë procesin nën përgjegjësinë e kompanive postare si DHL apo UPS. Ato kanë një eksperiencë të madhe me shpërndarjen e dokumenteve me natyrë sensitive. Në këto kompani nuk ka përfshirje të shtetit shqiptar dhe nuk diskutohen manipulime të votës. Këto kompani kanë interes të mbrojnë reputacionin e tyre dhe nuk gëzojnë “mbrojtje politike” në një përballje të mundshme me ligjin siç ndodh rëndom me militantët partiakë.

I vetmi detaj ku votimi drejtpërdrejtë konkuron votimin me postë është rreziku i “votimit familjar” apo “votimit në grup”. Nuk përjashtohen as “influenca” lobiste të shteteve pritëse të cilët mund të ushtrojnë presione anësore në këtë drejtim mbi shtetasit shqiptarë për të drejtën e votës. Megjithatë, duhet theksuar se migrantët shqiptarë jetojnë në Perëndim. Jetesa në shoqëri me standartet dhe kulturë të konsoliduar të lirisë do të limitojnë influencat negative të keqpërdorimit të së drejtës së votës.

- AFATET KOHORE

Procesi i votimit i cili do të zhvillohet jashtë territorit të Shqipërisë do të krijojë problemin e diferencës që “votate jashtme” nuk do të arrijnë të numërohen në të njëjtën kohë me “votate brendshme”...

Në çdo rast, procesi i votimit të jashtë vendit do të zhvillohet përpara votimit në Shqipëri. Votat e mbledhura do të vinë dhe do të numërohen në strukturën e ngritur për këtë qëllim ose përpara zhvillimit të votimit në Shqipëri ose pasi ky të ketë përfunduar. Numërimi i këtyre votave përpara zhvillimit të votimeve në Shqipëri do të ishte i preferueshëm pasi rezultatet do të shpalleshin njëkohësisht me ato të votave të brendshme, duke shmangur ose minimizuar mundësinë e kontestimeve të rezultateve.

Për sa i përket afateve kohore, votimi me postë ofron zgjidhjen më të mirë të problemit. Shërbimet e specializuara në shpërndarjen dhe mbledhjen e postës kanë efikasitet në kryerjen e këtyre shërbimeve që asnjë strukturë apo institucion i shtetit shqiptar nuk do të mund ta arrinte për arsye objektive të mungesës së eksperiencës apo të infrastrukturës së nevojshme.

- KOSTOT FINANCIARE

Kostoja e votimit me postë është më e ulët se sa e votimit të drejtpërdrejtë. Nga vlerësimi i përafërt e kostonë së votimit jashtë vendit me postë rezulton se ky proces do të kushtonte midis 20 – 25 dollarë për çdo “votues të jashtëm”. Kostoja mund të ulët me rritjen e pjesëmarrjes së votuesve. Nëse kihet parasysh kontributi ekonomik që japin shtetasit jashtë vendit një kosto e tillë është e arsyeshme. Ajo bëhet e pranueshme nëse merret parasysh fakti se për zgjedhjet brenda territorit të Shqipërisë kostoja shkon rreth 22 dollarë për votues (vlerësim para vitit 2009).

VI- ADMINISTRIMI I PROCESIT





VI

ADMINISTRIMI I PROCESIT

Procesi i votimit të jashtëm nisur nga regjistrimi i votuesve e deri tek numërimi i votave do të administrohet nga një strukturë e veçantë dhe e pavarur brenda KQZ e quajtur Komisioni Qëndror për Votën e Jashtme (KQVJ). Do të jetë detyra e kësaj strukture të bëjë verifikimin e të dhënave të shtetasve që shprehin dëshirën të votojnë dhe të administrojë regjistrimin e tyre, duke u dërguar kodet e regjistrimit dhe duke menaxhuar faqen e internetit për këtë qëllim. Kjo strukturë në bashkëpunim me KQZ duhet të bëjë po ashtu pastrimin e emrave të “votuesve të jashtëm” nga listat e votuesve që votojnë brenda territorit të Shqipërisë.

KQVJ do të jetë po ashtu përgjegjëse për të përzgjedhur shërbimin postar që do të kryejë shpërndarjen dhe mbledhjen e votave. Përzgjedhja do të bëhet me tender në bazë të çmimeve dhe të kushteve të sigurisë që ofron secili kandidat.

KQVJ do të asistojë po ashtu shërbimin postar në dërgimin e fletëve të duhura të votimit votuesve të jashtëm si dhe numërimin dhe shpërndarjen e votave sipas qarqeve për të cilat është votuar.

-KONKLUZIONE

Nuk ka një qëndrim uniform lidhur me mënyrat e votimit apo kategoritë e shtetasve që mund të votojnë jashtë territorit të një shteti. Pavarësisht nga kjo, pjesa më e madhe e shteteve njohin të drejtën për të votuar jashtë territorit të shtetasve të tyre, kryesisht të atyre me qëndrim afatshkurtër dhe përgjithësisht për zgjedhjet parlamentare.

Numri i shteteve që nuk e njohin për asnjë kategori votimin jashtë vendit është tejet i kufizuar. Ndër to përfshihet edhe Shqipëria... Në kuadrin e atyre shteteve që nuk e njohin këtë mundësi, janë edhe ata që kanë parashikuar lehtësira të tjera si psh: votimi paraprak apo rimbursim i kostove të udhëtimit. Kjo qasje e përgjithshme për të drejtën e votës jashtë vendit është në përputhje edhe me parimin e universalitetit të votës, që nga ana tjetër, kërkon nxitjen e shtetasve për të votuar, duke hequr cdo barrierë.

Asambleja e Këshillit të Evropës, Komisioni i Venecias por, edhe jurisprudenca GJEDNJ, po orientojnë shtetet drejt gjetjes së mënyrave për të krijuar mundësi efektive për votimin jashtë vendit të shtetasve të tyre. Kjo qasje merr në konsideratë mobilitetin e shtuar të shoqërisë njerëzore, përfitimet nga ky mobilitet për shtetet e origjinës, por në të njëjtën kohë edhe të drejtën për t'u përfaqësuar. Komisioni i Venecias kërkon lejimin e votimit kur numri i migrantëve është i konsiderueshëm në numër.

Dinamika e zhvillimit të shoqërisë shqiptare, ku migrimi u shndërrua në një cilësi kombëtare dhe impaktin ekonomik të migrimit në vend, kërkojnë domodoshmërisht marrjen e masave specifike për të mundësuar përfaqësimin real të migrantëve.

Mundësia e një studimi, fizibiliteti për të gjetur mundësitë më të mira të votimit jashtë vendit i cili nuk kompromenton transparencën e procesit do të ishte i dobishëm. Studimi mund t'i referohet praktikave më të mira në vendet e tjera si edhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias për këtë qëllim, duke balancuar gjetjet me specifikat e procesit zgjedhor në vend dhe kostot specifike për

këtë qëllim. Kjo duhet të pasohet me ndryshimet në Kodin Zgjedhor, për të qenë në koherencë me dispozitën kushtetuese për një të drejtë vote gjithëpërfshirëse si edhe me Ligjin për Emigrimin e Shtetasve Shqiptare për Motive Punësimi.

Nga krahasimi i të dy procedurave të votimit (elektronik dhe me postë) vlerësohet se votimi me postë ka avantazhe për rastin e Shqipërisë. Ai është më i thjeshtë dhe më pak i kushtueshëm për sa u përket kostove, administrimit dhe garancive të sigurisë se sa votimi i drejtpërdrejtë elektronik.

I takon Komisionit të Reformës Zgjedhore të bëjë propozimet fundore mbi bazën e të cilave Kuvendi i Shqipërisë do të vendosë për të drejtën e votës së gati gjysmës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Kjo do të shënojë një kapitull të ri për politikën dhe Shqipërinë.

MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

www.diaspora.gov.al